



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja d) nenet 24.1 dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenin 27 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me plotësim ndryshimet e bëra me Ligjin nr.04/L-194, nenin 2.3 të Ligjit nr.03/L-049 për financat e pushtetit lokal, nenit 8 paragrafët 6 dhe 7 të Ligjit nr.10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, si dhe nenet 14, 15 paragrafi 2.4, nenin 21 paragrafi 1 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS NGA VITI 2025 NË VITIN 2026 DHE DESTINIMIN NË KATEGORI DHE PROGRAME TË CAKTUARA BUXHETORE

Neni 1

Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës, të pashpensuara në vitin 2025 në shumën e gjithmbarshme 1,440,443.17€, nga e cila shuma prej 832,008.11€ është tejkalim i të hyrave vetanake të planifikuara në vitin 2025, barten në vitin 2026, në programet dhe kategoritë ekonomike, si në vijim:

1. Në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në nën programet si në vijim:

1.1. 48005-Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik, kodi funksional-0411, në projektet si në vijim:

- Ndërtimi i Tregut të Ri të Qytetit, kodi i projektit (55189), shuma.....252,682.40 €
Gjithsej.....252,682.40 €

Arsyetim:

Projektet të cilat barten në programin 48005-Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik nga të hyrat vetanake në të gjitha projektet, janë obligime kontraktuale andaj është e domosdoshme që mjetet në vlerë 252,682.40 euro të barten në programin 48005 në kodet e projekteve të cilat janë të specifikuar më lartë.

1.2. 18165-Infrastruktur Publike, kodi funksional-0451, në projektet si në vijim:

- Rregullimi i Infrastrukturës së varrezave të qytetit, kodi i projektit (54592), shuma.....115,510.48 €
Gjithsej.....115,510.48 €

Arsyetim:

Projektet të cilat barten në programin 18165-Infrstruktura Publike nga të hyrat vetanake në të gjitha projektet, janë obligime kontraktuale andaj është e domosdoshme që mjetet në vlerë 115,510.48 euro të barten në programin 18165 në kodet e projekteve të cilat janë të specifikuar më lartë.

1.3. 66030-Planifikim Hapësinor dhe Rregullativ, kodi funksional-0620, në projektet si në vijim:

- Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Xhemajl Mustafa" me infrastrukturë përcjellëse, kodi i projektit (49281), shuma.....147,627.96 €
- Ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistralja Podujevë-Prishtinë deri në rrugën "Vllëzërit Frashëri" si dhe rrugën "Shaban Shala" me rrugën "28 Nëntori", kodi i projektit (51911), shuma.....153,849.67 €

Gjithsej.....301,477.63 €

Arsyetim:

Projektet të cilat barten në programin e Planifikimit Hapësinor dhe Rregullativ-66030 në vlerë totale 301,477.63 euro, nga këto projekti Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Xhemajl Mustafa" me infrastrukturë përcjellëse, kodi i projektit (49281) është obligim kontraktual ku këto mjete nevojiten për realizmin e projektit të kontraktuar. Ndërsa Ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistralja Podujevë-Prishtinë deri në rrugën "Vllëzërit Frashëri", si dhe rrugën "Shaban Shala" me rrugën "28 Nëntori", kodi i projektit (51911) është faturë e papaguar nga punët e kryera.

1.4. 73300-Shërbimet e Shëndetësisë primare, kodi funksional-0721, në projektet në vijim:

- "Ndërtimi i QMF-III – Podujevë, Bashkëfinancim me Qatar Charity – Kosova", kodi i projektit (51915), shuma prej.....77,829.00 €

Gjithsej.....77,829.00 €

Arsyetim:

Projektet të cilat barten në programin 73300-Shërbimet e Shëndetësisë Primare janë obligime të papaguara, andaj është e domosdoshme që mjetet në vlerë 77,829.00 euro të barten në programin 73300 në kodet e projekteve të cilat janë të specifikuar më lartë.

1.5. 92290-Arsimi parafillor çerdhet, kodi funksional-0911, në projektet si në vijim:

- "Ndërtimi i Kuzhinës qendrore për fëmijë në çerdhe dhe nxënës të shkollave në Podujevë", kodi i projektit (55835), shuma prej.....203,000.00 €

Gjithsej.....203,000.00 €

Arsyetim:

Projektet të cilat barten në programin 92290 - Arsimi parafillor çerdhet, janë obligime kontraktuale, andaj është e domosdoshme që mjetet në vlerë 203,000.00 euro të barten në programin 92290 në kodin e projektit 55835-"Ndërtimi i kuzhinës qendrore për fëmijë në çerdhe dhe nxënës të shkollave në Podujevë".

1.6. 93120-Arsimi fillor, kodi funksional-0912, në projektet si në vijim:

- "Ndërtimi i sallës së brendshme sportive në shkollën "Ali Ajeti" në Sfeçël", kodi i projektit i ri, shuma prej.....	206,452.34 €
- "Ndërtimi i shkollës në Shajkoc-ShFMU "Hasan Ramadani" Shajkoc", kodi i Projektit (54258), shuma prej.....	75,730.24 €
- "Ndërtimi i aneksit të shkollës "Naum Veqilharxhi" në Llapashticë , kodi i projektit (55870), shuma prej.....	45,938.00 €
Gjithsej.....	328,120.58 €

Arsyetim:

Projektet të cilat barten në programin 93120- Arsimi fillor janë obligime kontraktuale, andaj është e domosdoshme që mjetet në vlerë 328,120.58 euro të barten në programin 93120 në kodin e projekteve të lartcekura.

2. Në kategorinë e mallrave, në nën programet si në vijim:

2.1. 93120-Arsimi fillor, kodi funksional-0912, në projektet si në vijim:

- Furnizimi me lëndë djegëse - dru, shuma prej.....	86,000.00 €
Gjithsej.....	86,000.00 €

Arsyetim:

Mjetet financiare të cilat barten në programin 93120 - Arsimi fillor janë për një faturë të papaguar furnizimet e të cilave janë bërë gjate muajit janar 2026, andaj është e domosdoshme që mjetet në vlerë 86,000.00 euro të barten në programin 93120.

3. Në kategorinë e shpenzimeve komunale, në nën programet si në vijim:

3.1. 16305-Administrata, kodi funksional-0133, si në vijim:

- Shpenzime komunale, shuma prej.....	24,293.08 €
Gjithsej.....	24,293.08 €

3.2. 73300-Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor, kodi funksional-0721, si në vijim:

- Shpenzime komunale, shuma prej.....	20,132.00 €
Gjithsej.....	20,132.00 €

3.3. 92290-Arsimi Parafillor Çerdhet, kodi funksional-0911, si në vijim:

- Shpenzime komunale, shuma prej.....	1,264.00 €
Gjithsej.....	1,264.00 €

3.4. 94320-Arsimi Mesëm, kodi funksional-0922 , si në vijim:

- Shpenzime komunale, shuma prej.....30,134.00 €
Gjithsej.....30,134.00 €

Arsyetim:

Bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve komunale ne programet e sipërme në shumë të përgjithshme në të gjitha programet prej 75,823.08 €, bëhet për mbulimin e obligimeve të papaguara dhe që do të rrjedhin gjatë vitit fiskal 2026.

4. Arsyetim për kategoritë:

Komuna e Podujevës të gjitha të hyrat vetanake ka nevojë ti bartë në kategorinë e investimeve kapitale për arsye të obligimeve kontraktuale ne pjesën dërmuese te projekteve të cilat do të barten në këtë vendim. Në kategoritë e tjera si mallra, subvencione, komunalit nuk kemi nevojë për mjete shtese ne bazë te ecurive buxhetore të vitit 2026.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi, nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës, kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave.

Nr.Prot. 01-400/03-0037575/26
Podujevë, datë; 29 qershor 2026

